FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

KARDIOSPIR

Tableta me veshje enterike (gastro – rezistente) – 100 mg

(Acid acetilsalicilik)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Kardiospir dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Kardiospir
3. Si ta merrni Kardiospir
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Kardiospir
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KARDIOSPIR DHE PËRSE PËRDORET
Kardiospir përmban lëndën aktive acid acetilsalicilik. Acidi acetilsalicilik (aspirina) është një antiinflamator josteroid (AIJS) i grupit të salicilateve dhe ka shumë karakteristika të përbashkëta me antiinflamatorët e tjerë josteroidë (AIJS). Ai jep efekte analgjezike, antipiretike, antiinflamatore dhe antireumatike. Acidi acetilsalicilik e ul temperaturën e lartë të trupit me anën e zgjerimit të enëve periferike të gjakut. Veprimin antiinflamator dhe analgjezik e ushtron me anën e frenimit të kompleksit enzimatik prostaglandinë-sintetazë. Acidi acetilsalicilik, duke acetiluar ciklooksigjenazën e trombociteve, parandalon sintezën e tromboksanit A2, një rrjedhës i prostaglandinës, që është një vazokonstriktor i fuqishëm e që nxit agregimin e trombociteve dhe reaksionin e çlirimit të trombociteve. Acidi acetilsalicilik e frenon agregimin e trombociteve.

Indikohet në:
- profilaksinë e sëmundjeve cerebrovaskulare ose të infarktit të miokardit (për shkak të efektit antitrombocitar);
- anginën e paqëndrueshme (një tip i veçantë, i rrezikshëm, i sëmundjes së koronareve të zemrës, që shoqërohet me dhimbje gjoksi edhe në qetësi);
- goditjet e vogla në tru (insultet cerebrale ishemike, përfshirë edhe krizat kalimtare të trurit).

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Kardiospir për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Kardiospir.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KARDIOSPIR
Mos merrni Kardiospir në qoftë se:
- vuani nga mbindjeshmëria ndaj acidit acetilsalicilik apo ndonjërës prej lëndëve të tjera (eksipientëve) të Kardiospir;
- vuani nga mbindjeshmëria ndaj salicilateve të tjerë apo ndaj antiinflamatorëve josteroidë (ju është shfaqur: astmë, angioedemë, urtikarie apo rinit pasi keni marrë acid acetilsalicilik (aspirin) ose antiinflamatorë të tjerë josteroidë);
- vuani nga hemofilia dhe çrregullime të tjera të koagulimit të gjakut;
- pacienti është nën 16 vjeç, për shkak të rrezikut të shfaqjes së sindromit Reye; në këtë rast, nëse ka indikacion të veçantë, vetëm mjeku mund të vendosë për përdorimin e barit;
- vuani nga ulçera peptike aktive.

Tregoni kujdes të veçantë me Kardiospir
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Kardiospir në qoftë se:
- keni vuajtur më parë nga ulçera peptike;
- keni anemi;
- keni dëmtim të veshkave, të mëlçisë (nuk duhet përdorur në qoftë se dëmtimi është i rëndë) ose tek të sëmurët që janë të dehidratuar;
- keni tirotoksikozë;
- jeni të sëmurë me astmë;
- vuani nga sëmundje alergjike;
- vuani nga hipertensioni i pakontrolluar dhe nga pamjaftueshmëria e glukozë-6-fosfatdehidrogjenazës;
- përdorni metotreksat në dozën 15 mg / javë ose më shumë;
- jeni shtatzënë; duhet mënjanuar gjatë tremujorit të fundit;
- jeni ende në periudhën e ushqyerjes me gji të fëmijëve;
- jeni i moshuar.

Acidi acetilsalicilik nuk duhet përdorur për mjekimin e gutës.

Marrja e barnave të tjerë
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjerë mund të ndikojë ose të ndikohet nga Kardiospir. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjerë, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Kardiospir në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
- Acetazolamidi mund të shtojë ekskretimin urinar për sa kohë urina është alkaline, ndërsa acidi acetilsalicilik mund të rrisë toksicitetin e acetazolamidit në S.N.Q.
- Acidi acetilsalicilik mund të pakësojë efektin diuretik të spironolaktonit dhe diuretikëve të ansës.
- Acidi acetilsalicilik shton efektin antikoagulant dhe rrit rrezikun për hemorragji kur jepet së bashku me heparinën ose antikoagulantët oralë.
- Acidi acetilsalicilik pakëson efektin antihipertensiv të ACE-inhibitorëve dhe beta-bllokuesve.
- Kombinimi i acidit acetilsalicilik me barna të tjerë antiinflamatorë josteroidë nuk ofron ndonjë avantazh terapeutik, ndërkohë që shton incidencën e efekteve anësore.
- Acidi acetilsalicilik mund të shtojë përqëndrimet plazmatike dhe për pasojë toksicitetin e acidit valproik.
- Acidi acetilsalicilik pengon sekretimin tubular të metotreksatit duke rritur kështu toksicitetin e tij.
- Acidi acetilsalicilik i kombinuar me barna për trajtimin e depresionit (si frenuesit selektivë të rikapjes së serotoninës apo venlafaksinë) rrit rrezikun për gjakrrjedhje.
- Acidi acetilsalicilik duhet përdorur me kujdes edhe me këto barna: digoksin, ciklosporinë, probenecid, sulfinpirazon, sulfonilureikë, kortikosteroide.
- Metamizoli (bar që ul dhimbjen dhe temperaturën) mund të zvogëlojë efektin e acidit acetilsalicilik në agregimin e pllakëzave (procesi i ngjitjes së qelizave të gjakut me njëra-tjetrën për të formuar një tromb) kur merren njëkohësisht. Kështu që ky kombinim duhet përdorur me kujdes tek pacientët që marrin acid acetilsalicilik me dozë të ulët për të mbrojtur zemrën.

Marrja e Kardiospir me ushqim dhe pije
Kardiospir nuk duhet marrë së bashku me pije alkoolike dhe duhet marrë gjithmonë gjatë ose pas ushqimit.

Shtatzënia
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Duhet përdorur me kujdes gjatë shtatzënisë dhe duhet evituar gjatë tremujorit të fundit të saj. Mund të shkaktojë hemorragji, vonesë dhe ngadalësim të lindjes, mbyllje intrauterine të duktusit arterioz dhe kernikterus tek të porsalindurit.

Ushqyerja me gji
Salicilatet ekskretohen me qumështin e gjirit. Për këtë arsye është mirë që të përdoren me kujdes gjatë ushqyerjes me gji të fëmijëve.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna, por përgjithësisht nuk janë vënë re efekte që ndikojnë në drejtimin e automjetit apo përdorimin e makinerive.

IInformacion i rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse e Kardiospir
Ky bar përmban azongjyruesin *Sunset* i verdhë FCF (E110), i cili mund të shkaktojë reaksione alergjike.

3. SI TA MERRNI KARDIOSPIR
Gjithmonë merreni Kardiospir sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Kardiospir janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Tabletat duhet të gëlltiten me një gotë ujë (200 - 250 ml) gjatë ose pas ushqimit. Gëlltitini tabletat të plota, të shoqëruara me ujë. Mos i shtypni, thërrmoni apo përtypni tabletat pasi këto veprime dëmtojnë veshjen e veçantë, e cila pengon çlirimin e acidit acetilsalicilik në stomak.

Dozimi jepet si më poshtë:
Kur e përdorni acidin acetilsalicilik për qëllimet e mësipërme për herë të parë, ka mundësi që mjeku të udhëzojë që ju të merrni dy tableta 100 mg.

Më pas, doza e zakonshme e këshilluar është një tabletë 100 mg në ditë, megjithëse mjeku mund t'ju udhëzojë të përdorni një dozë më të madhe.
Për veprimin antitrombotik (antiagregant): për efektin e tij antitrombotik pas infarktit të miokardit, krizave iskemike kalimtare ose tek të sëmurët me anginë të paqëndrueshme, doza e rekomanduar është 100 - 300 mg në ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Kardiospir
Në qoftë se keni marrë më shumë Kardiospir se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Trajtimi: Në rastet kur rrezikohet jeta për shkak të një intoksikimi të rëndë, duhen marrë menjëherë masat për të mos lejuar përthithjen e mëtejshme të barit. Duhet praktikuar një lavazh gastrik, duhet administruar karbon aktiv, duhen kontrolluar dhe duhen korrigjuar elektrolitet. Në rast se është e nevojshme mund të bëhet edhe hemoperfuzion ose hemodializë.

Në qoftë se harroni të merrni Kardiospir
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjithë barnat e tjerë, Kardiospir mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Kardiospir tolerohet mirë në dozat e rekomanduara. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:
- çrregullime gastrointestinale ose të përziera;
- ulçera me hemorragji të fshehta (ndonjëherë edhe hemorragji serioze);
- hemorragji të tjera p.sh.: subkonjunktivale;
- çrregullime të të dëgjuarit, p.sh. zhurmë në vesh (në raste të rralla mund të çojë në shurdhim);
- marrje mendsh, konfuzion mendor;
- reaksione mbindjeshmërie (angioedemë, bronkospazma dhe ekzantema);
- rritje e kohës së koagulimit;
- në raste të rralla edema;
- miokardit;
- çrregullime të gjakut, veçanërisht trombocitopeni.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj. Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me Kardiospir duhet ndërprerë dhe ju duhet të këshilloheni me mjekun ose me farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KARDIOSPIR
Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Kardiospir pas datës së skadencës të shënuar në paketim!.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Kardiospir
Lënda aktive është acid acetilsalicilik.
Çdo tabletë me veshje enterike përmban 100 mg acid acetilsalicilik.
Lëndët ndihmëse: celulozë mikrokristalore, kroskarmelozë natriumi, amidon i prexhelatinizuar, dioksid silici koloidal, glikolat natriumi i amidonit, acid stearik, kopolimer i acidit metakrilik, talk, oksid hekuri i verdhë, dioksid titani, citrat trietili, *Sunset* i verdhë FCF (E 110), silic, bikarbonat natriumi, lauril sulfat natriumi, hipromelozë, triacetin.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 20 tableta me veshje enterike (gastro-rezistente).

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.